



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.04.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik "Marisa" Sh.p.k. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511, **nxjerr:**

V E N D I M

- Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Marisa" Sh.p.k., e dt.23.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 08.04.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- Korigjohet** pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 08.04.2024;
- Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj korigjimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Marisa" SH.P.K., me dt.23.04.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Të gjitha pretendimet të cilat janë aprovuar OE ankues me vendimin e OSHP-së 2024/0031, do të merren parasyshë dhe do të ndryshohen dokumentet e tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

